

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.16,22,29.10.2020*

16.12.2020

Ora 12:05

**RENDI I DITËS**

*Shqyrtimi i projektaktit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zotin Armand Halit Rama me funksion këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Z.Illirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Znj.Edlira Jorgaqi, këshilltare e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**

**Z.Ylli Merkaj, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së**

**Z.Magdalena Koja, Drejtore e Drejtorisë Juridike**

**Të tjerë:**

**Z.Aleksandër Rama, anëtar i Këshillit të Bashkisë Tiranë**

**Z.I.Celibashi:** Mirëdita, çelim sot këtë seancë publike për të shqyrtuar rezultatin e verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zotin Armand Halit Rama, me funksion këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tiranë. Atëhere, Ju jeni zoti Armand?

**Z.Armand Halit Rama!** Po!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.16,22,29.10.2020*

**Z.I.Celibashi:** Jeni prezent, para se të fillojmë shqyrtimin, keni ndonjë kërkesë paraprake?


**Z.Armand Halit Rama!** Po! faktikisht, unë dje u lajmërova për këtë seancë dhe nuk kisha kohën e mjaftueshme për t'u njohur me dosjen. Do të kërkoja nga ju shtyrjen e kësaj seance në një afat të caktuar që ju e mendoni që të njihem me dosjen, me termat juridikë që ndoshta do të konsultohem me një avokat.

**Z.I.Celibashi:** Dakord, do ta shtyjme, seancën tjetër do ta lemë në datën 22.12.2020 në orën 12:00. Besoj keni kohë mjaftueshëm?

**Z.Armand Halit Rama!** Po, faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit juve, seanca mbyllet për sot, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.16,22,29.10.2020*

22.12.2020

Ora 12:00

**RENDI I DITËS**

*Shqyrtimi i projektaktit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zotin Armand Halit Rama me funksion këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Z.Ylli Merkaaj, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së**

**Z.Madalena Koja, Drejtore e Drejtorisë Juridike**

**Të tjerë:**

**Z.Gentjan Rumano, Përfaqësues ligjor i zotit Armand Rama.**

**Z.Y.Merkaaj:** Përhëndetje, për arsye se Komisioneri Shtetëro i Zgjedhjeve ka një takim të rëndësishëm me persona që janë jashtë vendit dhe nuk mund të zhvillohet sot kjo seancë. Do të vendosim të shtyhet seanca e radhës në datën 29.12.2020 në orën 11:00.

**Z.Gentjan Rumano, përfaqësues ligjor i zotit Armand Rama:** Unë do të përfaqësoj klientin Rama, për datën nuk e kam problem, por për shkak të impenjimeve në këtë orë meqenëse kam një çështje në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Durrës, do t’u lutesha për një orë tjetër nqs është e mundur.

**Z.Y.Merkaaj:** Dakord e lemë në datën 29.12.2020 në orën 13:00, gjithësesi do ta bisedoj me Komisionerin dhe nqs do të kemi ndryshim të orës do t’u njoftojmë, ditën e mirë.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.16,22,29.10.2020*

29.12.2020

Ora 13:00

**RENDI I DITËS**

*Shqyrtimi i projektaktit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zotin Armand Halit Rama me funksion këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Z.Illirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Z.Ylli Merkaç, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së**

**Z.Madalena Koja, Drejtore e Drejtorisë Juridike**

Hapet seanca me objekt “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zotin Armand Halit Rama me funksion këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Verifikohet prania e palëve që nuk janë prezent. Është bërë një kërkesë për dorëheqje dorëzuar në Sektorin e Administrimit, Arkivimit të Dokumentacionit me nr.2655, dt.29.12.2020. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur për shkak të dorëheqjes së zotit Armand Halit Rama nga funksioni i anëtarit të Këshillit Bashkiak, Tiranë. **Vendimi nr.42**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

